NEWSBOMB 8°C
Tirane
Max: 11°C Min:
7:07 am 4:26



# Sekuestrohen armë, drogë dhe municione luftarake, arrestohen 4 persona në Kukës

Publikuar tek: AKTUALITET, më 11:46 03-10-2019



**Vijon operacioni "Kopshti i Skacajve", ku janë arrestuar në flagrancë 4 shtetas.**

Në bazë të hetimeve të kryera rezultoi se A. H., 33 vjeç, R. T., 23 vjeç, banues në Pukë, K. M., 25 vjeçe dhe F. M., 19 vjeç, do të këmbenin një sasi lënde narkotike, armatim dhe municion luftarak.

Gjatë kontrollit të ushtruar nga policia, në automjetet e tyre u sekuestruan rreth 3 kg lëndë narkotike, 2 armë tip automatik, si dhe rreth 900 fishekë.

***Njoftimi i Policisë:***

Operacioni nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës në bashkëpunim me SHÇBA-në dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës.



NEWS SPORT


Kliko këtu për të parë videot
BOMB VIDEO



Arrestohen në flagrancë 4 shtetas.

Sekuestrohen drogë, armë zjarri e municione luftarake.

Strukturat e DVP Kukës, në bashkëpunim me SHÇBA-në dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës, në vijim të operacionit të koduar "Kopshti i Skacajve", për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve arrestuan në flagrancë 4 shtetas, konkretisht:

1. H., 33 vjeç, R. T., 23 vjeç, banues në Pukë, K. M., 25 vjeçe dhe F. M., 19 vjeç, banues në Shemri, Kukës.

Në bazë të hetimeve të kryera rezultoi se këta shtetas do të këmbenin një sasi lënde narkotike, armatim dhe municion luftarak.

Shërbimet e Policisë të DVP Kukës kanë ndërhyrë në vendin e quajtur "Qafë-Shllak" dhe kanë bërë të mundur ndalimin e këtyre shtetasve, të cilët lëviznin me mjetet tip "Benz" dhe "Opel".

Gjatë kontrollit të ushtruar nga policia, në automjetet e tyre u konstatuan dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale rreth 3 kg lëndë narkotike, 2 armë tip automatik, si dhe rreth 900 fishekë.

Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike" dhe "Armëmbajtja pa leje".

Oops!

We couldn't find your video.

## SONDAZH

**Krahasuar me një vit më parë, nata e ndërrimit të viteve për ju është:**



















HOROSKOPI 2020

## SHTYPI I DITËS

## SONDAZH



**Krahasuar me një vit më parë, nata e ndërrimit të viteve për ju është:**

- Më e pasur
- Më e varfër